

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
SHOQERIA TREGTARE  
"ENBI POWER" SHPK TIRANE

VENDIM Nr. 02, DATE, 28.06.2011  
I ORTAKUT TË VETEM TE SHOQËRISË  
"ENBI POWER" SHPK TIRANE

Në Tiranë, sot në datën 28, muaji Qershor, viti 2011, Ortaku i Vetem i Shoqërisë Tregtare "ENBI POWER" SHPK, në selinë e saj mori në shqyrtim rendin e ditës:

- Shqyrtimin e veprimtarisë tregtare dhe treguesve financiarë të Shoqërisë Tregtare "ENBI POWER" SHPK, për vitin financiar 2010 si dhe ecuria e saj në të ardhmen.
- Përcaktimin e llogarive vjetore të Shoqërisë Tregtare "ENBI POWER" SHPK për vitin financiar 2010 të mbyllur me 31 Dhjetor 2010;
- Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë Tregtare "ENBI POWER" SHPK;
- Caktimin e Ekspertit Kontabel të Regjistruar për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2011.

Ortaku i Vetem i Shoqërisë Tregtare z. TAJAR BREGASI, pasi u njoh me rendin e ditës;

V Ë R E N S E

Shoqëria Tregtare "ENBI POWER" SHPK, është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit me Vendimin Nr. 32067, date 07.09.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Ortak të Vetem dhe Administrator z. TAJAR BREGASI.  
Gjatë shqyrtimit të veprimtarisë tregtare dhe treguesve financiarë të Shoqërisë Tregtare "ENBI POWER" SHPK, Ortaku i Vetem konstaton se për të patur një vazhdimësi dhe siguri të veprimtarisë, si dhe për të rritur treguesit financiarë, të bëhet zmadhimi i kapitalit themeltar i kësaj shoqërie, në bazë të Statutit, Aktit të Themelimit dhe Ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" nepermjet fitimeve të pashperndara, sipas gjendjes së bilancit të datës 31.12.2010.

Për këto arsye, Ortaku i Vetem i Shoqërisë tregtare "ENBI POWER" SHPK, z. TAJAR BREGASI, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

V E N D O S I

- Miratimin e llogarive vjetore të Shoqërisë Tregtare "ENBI POWER" SHPK për vitin financiar 2010 të mbyllura me 31 Dhjetor 2010;
- Zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare "ENBI POWER" SHPK, nepermjet fitimeve të pashperndara të shoqërisë, gjendje më datë 31.12.2010;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anëtar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, me Nr. license profesionale 97 date 10.01.2001, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me fitimet e pashperndara;
- Emerimin e z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabel i Regjistruar për auditimin e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2011;
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË  
"ENBI POWER" SHPK TIRANE

TAJAR BREGASI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
SHOQERIA TREGTARE  
"ENBI POWER" SHPK  
TIRANE

VENDIM NR. 03, Datë 14.07.2011,  
I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË TREGTARE  
"ENBI POWER" SHPK TIRANE

Në Tiranë, sot në datën 14, muaji Korrik, u mblodh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare "ENBI POWER" SHPK, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të pashperndara për Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të Shoqërisë, të datës 13 Korrik, i përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Regjistruar;

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, z. TAJAR BREGASI, pasi u njoh me rendin e ditës;

V Ë R E N S E

Shoqëria Tregtare "ENBI POWER" SHPK, është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit, sipas vendimit Nr. 32067, date 07.09.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie është z. TAJAR BREGASI. Kapitali Aksionar i kësaj shoqërie është 57,461,000 (Pesedhjetë e shtate milion e katerqind e gjashtedhjetë e nje mije) Lekë. Kështu, z. TAJAR BREGASI, zotëron 100% të kapitalit themeltar të nënshkruar, i barabartë ky me 100 (njëqind) kuota me vlerën 57,461,000 (Pesedhjetë e shtate milion e katerqind e gjashtedhjetë e nje mije) Lekë, ku secila kuota ka vlerën prej 574,610 (Peseqind e shtatedhjetë e kater mije e gjashteqind e dhjetë) Lekë;

Me Vendimin Nr. 02, datë, 28.06.2011, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka vendosur:

- Miratimin e llogarive vjetore të Shoqërisë Tregtare "ENBI POWER" SHPK për vitin financiar 2010 të mbyllura me 31 Dhjetor 2010;
- Zmadhimin e kapitalit aksionar të shoqërisë tregtare "ENBI POWER" SHPK, nepermjet fitimeve të pashperndara të shoqërisë, gjendje më datë 31.12.2010;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anëtar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, me Nr. license profesionale 97 date 10.01.2001, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksionar me fitimet e pashperndara;
- Emerimin e z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabel i Regjistruar për auditimin e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2011;
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit.

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të pashperndara për Zmadhimin e Kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 13.07.2011, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Regjistruar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar.

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit aksionar të shoqërisë bëhet nga 57,461,000 (Pesedhjetë e shtate milion e katerqind e gjashtedhjetë e nje mije) Lekë në 92,500,000 (Nentëdhjetë e dy milion e peseqind mije) leke, e barabartë kjo me 100 (Njeqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 925,000 (Nentëqind e njezet e pese mije) Lekë. Pra, numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit themeltar të nënshkruar mbetet i pandryshueshëm dhe vetëm vlera nominale e tyre rritet.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:

**Z. TAJAR BREGASI**, do të jetë përsëri zotëruar i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 100 (njeqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuota (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 925,000 (Nentëqind e njezet e pese mije) Lekë.

Për këto arsye, Ortaku i Vetëm, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

V E N D O S I

- Miratimin e Raportit të Ekspertit për vlerësimin e fitimeve të pashperndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë të datës 13 Korrik 2011 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabel i Regjistruar;
- Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të kësaj shoqërie nga 57,461,000 (Pesedhjetë e shtate milion e katerqind e gjashtedhjetë e nje mije) Lekë në 92,500,000 (Nentëdhjetë e dy milion e peseqind mije) Leke, e barabartë kjo me 100 (Njeqind) kuota (pjesë) kapitali dhe kallimin e pjeses së mbetur nga fitimi i vitit 2010 në rezerva ligjore ;
- Numeri i kuotave (pjesëve) të kapitalit, mbetet i pandryshueshem, dhe rritet vetem vlera nominale e tyre;
- Vlera e cdo kuote (pjesë) kapitali kalon nga 574,610 (Peseqind e shtatedhjetë e kater mije e gjashteqind e dhjetë) Lekë në 925,000 (Nentëqind e njezet e pese mije) Lekë;
- Z. TAJAR BREGASI, do të jetë përsëri zotëruar i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 100 (njeqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuota (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 925,000 (Nentëqind e njezet e pese mije) Lekë;
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit .

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË TREGTARE  
"ENBI POWER" SHPK

TAJAR BREGASI

